REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5952 **Prot.** **Lushnje më,** 14/07/**2025**

PROJEKT - VENDIM Nr. 64

" PËR RREGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVESISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2025 sipas dokumentacionit dhe relacionit të paraqitur në mbështetje të *nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2gërma"a"dhe"c",pika 1.6 gërma "a",neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*,Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2,pika 4,pika 6,gërma"a"pika 9.1,VKM nr.89 datë 13.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,paragrafi II rregjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik,të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent,si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj"si edhe nenit 193/b të Kodit Civil **JU** :

PROPOZOJMË :

I. Të miratohet përfundimi i procedurave të rregjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga njësia vendore,*sipas dokumentacionit përkatës të ndodhur në dosje për* **Z.Spartak Çuko** (Bashkëpronarë).Të paguhet vlera e truallit në shumen 239326(dyqind e tridhjetë e nëntë e treqind e njëzet e gjashte) lek

II. Të miratohet përfundimi i procedurave të rregjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga njësia vendore,*sipas dokumentacionit përkatës të ndodhur në dosje për* **Z.Ardian Gjyshja dhe Z.Agnest Caka**

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnje ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Transferuar
Evelola Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE,PROKURORIMEVE DHE ASETEVE

Nr.5952 Prot.

Lushnje më, 14 / 07 /2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

" PËR RREGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVESISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Të nderuar këshilltare/këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkise Lushnje,janë paraqitur kërkesat e Z.Spartak Çuko(bashkëpronarët)dhe z.Ardian Gjyshja për të përfunduar proçedurën e rregjistrimit të truallit të dhënë për ndërtim nga njësia vendore e cila ka mbetur pa u regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjensisë Shtetrore të Kadastrës " ASHK "Lushnje.

Aplikuesi **Z.Spartak Çuko** me adresë lagjia "Kongresi" Njësia Administrative Nr.2 Bashkia Lushnje ka paraqitur dokumentacion të plotë referuar VKM-sw nr.329,datë 22.05.2019 " Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetrore të kadastrës,për rregjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje,për efekt rregjistrimi" pika 2, pika 11.Vendim nr.28,datë 30.10.1993 për dhënie sheshi ndërtimit me sipërfaqe 400m2 të miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Lushnje. Vendim nr.12,datë 26.03.1994 për miratimin e lejes së ndërtimit nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Lushnje. Plan rilevimi datë 18.05.2025 të zonës kadastrale nr.3268,shkresës me nr.3539 prot Datë 08.07.2025 të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetrore të Kadastrës Lushnje ku pasuria me nr.2/39 në zona kadastrale 3268 është tokë shtet fshati Savër Lushnje. Dokumenti që këtij aplikues i mungon që të kryej rregjistrimin e tokës truall është kontrata e shitblerjes së tokës përpara noterit dhe kryerjes së pagesës së truallit në shumën 239326 (dyqind e tridhjetë e nëntë e treqind e njëzet e gjashte) lek.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Nr.

Aplikuesi **Z.Ardian Gjyshja** e të tjerë me adresë lagjia "Loni Dhamo" Njësia Administrative Nr.2 Bashkia Lushnje ka paraqitur dokumentacion të plotë referuar pikës 2, pikës 11 të VKM-së nr.329,datë 22.05.2019 " Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetrore të Kadastrës,për rregjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt rregjistrimi".Vendim për dhënie sheshi ndërtimit me sipërfaqe 434 m2 të miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Lushnje .Vendim nr.12,datë 05.09.1995 për miratimin e lejes së ndërtimit nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Lushnje. Plan rilevimi datë 03.06.2025.Vërtetimi datë 07.05.2025 i Agjensisë Shtetrore të Kadastrës Lushnje. Kontratë shitje trualli nga Seksioni i financës së Këshillit të Rrethit Lushnje datë 23.07.1996. Mandat arkëtimi Banka e Kursimeve datë 21.08.1998. Kontratë noteriale nr.257 rep,nr.276 kol datë 23.07.1996, Kontratë nr.reptori 722,nr.koleksioni 441 datë 04.07.2025 ku shtetasi Ardian Gjyshja dhe shtetasi Agnest Caka janë bashkëpronar të ndërtesës së blerë mbi truallin objekt rregjistrimi.Shkresës nr.3583,datë 10.07.2025 të Agjensia Shtetrore e Kadastrës,Drejtoria Vendore e ASHK Lushnje ku pasuria me nr.15/24 Zona Kadastrale 8572 është pronë shtet.

Dokumenti që aplikuesve u mungon që të kryejnë rregjistrimin e tokës truall është kontrata e shitblerjes së tokës përpara noterit

Këtë atribut aktualisht, për miratimin e procedurës së privatizimit të tokës truall e ka Këshilli Bashkiak ku në zbatim të *nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2gërma"a" Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*; gërma "c" *E drejta që i mungon që të kryejë rregjistrimin e tokës truallështë kontrata e shitblerjes së tokës para noterit.Ky atribut ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër pika 1.6 gërma"a",neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar.Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2 *"Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për për qellime ndërtimi nga bashkitë,ish komunat dhe ish këshillat e rretheve (në vijim të quajtura "organe vendore"pas datës 10.08.1991*,pika 9.1,e kanë Këshillat Bashkiak, të cilat bëjnë të mundur lidhjen e kontratës së shitblerjes me Institucionin e Bashkisë Lushnje.

Faleminderit për mirëkuptimin !

DREJTORIA JURIDIKE
BEDRI HIDA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com